



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.24.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT
RAJONAL
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministrisë së Zhvillimit Rajonal*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Erëmira Bytyqi Pllana (Udhëheqës i ekipit) dhe Mazlumsha Sejfadini (Anëtar i ekipit)*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Florim Beqiri*.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	17
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	23
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	26

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZhR) për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 19.12.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i MZhR-së.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin se pasuritë kapitale dhe jokatitale nuk ishin shpalosur në mënyrë të drejtë në PFV, për shkak se ato ishin mbivlerësuar.

Më gjerësisht, shih kapitullin 2.1 të raportit.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrollet e raportimit për ta konfirmuar shpalosjen e drejtë të pasurive kapitale dhe jokapitale.



Ministri duhet t'i analizoj arsyet për Theksimin e Çështjes në 2018 dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë në vitin 2019 (shih opinionin e auditimit).

Dobësi evidente janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë prokurimin, fushën e pagesave, menaxhimin e pasurive dhe obligimeve të papaguara.



Ministri duhet të kryej një rishikim të procesit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të forcoj kontrollet aty ku dështimet janë identifikuar në proces (shih çështjet A2-A7).

Aranzimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial kanë nevojë edhe më tutje të përmirësohen. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është themeluar.



Ministri duhet të sigurojë që çështjet e dala nga fusha e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e llogaridhënies dhe raportimit menaxherial, përfshirë këtu themelimin e Njësies së Auditimit të Brendshëm (shih çështjet A8 dhe A9).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar dhe për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullores MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar të organizatave buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet lidhur me pasuritë kapitale dhe jokapitale, në pasqyrat financiare vjetore, nuk ishin të sakta, për shkak të çështjeve të identifikuara si në vijim:

- Neni 19.3.1- Pasuritë kapitale të regjistruara si investime në vijim, ishin mbivlerësuar për vlerën 110,250€. Këto pasuri kishin të bëjnë me disa projekte të komunave¹, të cilat

¹ "Hapja e rrugës Zlipotok-Brod" në vlerë 55,555€ dhe "Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Brodosan-Dragash" në vlerë 54,695€

ishin financuar nga ministria, por që nuk ishin bartur si pasuri në regjistrat e komunave përfituese, edhe pse për të njëjtat ishte bërë pranimi teknik. Kjo kishte ndodhur për shkak se zyra e financave e ministrisë nuk kishte dorëzuar dokumentacionin e plotë të pagesave të zyrtari i pasurisë për këto projekte.

- Neni 19.3.2- Pasuritë jokapitale të shpalosura në PFV në vlerën 50,903€, ishin të mbivlerësuara pasi për to nuk ishte kryer zhvlerësimi vjetor, por shpalosja ishte bërë me vlerën e tyre blerëse. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së përvojës të zyrtarit të pasurisë, duke qenë se ishte rekrutuar dhe çertifikuar nga fundi i vitit.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MZhR, kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Me këtë rast, ne kemi shqyrtuar çështjet si më poshtë:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat buxhetore siç janë: raportet tremujore, raportet operative;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Lidhur me PFV-të, përveç çështjes së ngritur tek Theksimi i Çështjes, ne kemi identifikuar se MZhR, nuk kishte shpalosur në mënyrë të drejtë obligimet e papaguara, si në vijim:

Neni 17 - Raporti për detyrimet e papaguara, të cilat ishin nënvlerësuar për vlerën prej 2,212€. Kjo, për shkak se dy fatura të muajit dhjetor 2018, të cilat ishin pranuar në MZhR në muajin janar 2019, nuk ishin paraqitur si obligime në PFV. Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtari përgjegjës i financave nuk kishte pasur njohuri se faturat që pranohen pas përfundimit të vitit fiskal duhet të paraqiten si obligime të papaguara në pasqyrat financiare vjetore.

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

Rekomandimi A1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë kapitale tek komunat për projektet e përfunduara, por që ende gjenden në regjistrin e pasurive të ministrisë. Gjithashtu, të siguroj se edhe procesi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale është kryer sipas kërkesave ligjore dhe të gjitha obligimet e pa paguara janë prezantuar drejt në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Duke qenë se MZHR, është institucion i ri, i themeluar në nëntor të vitit 2017 dhe është në konsolidim e sipër, kontrollet nuk kanë arritur të funksionojnë mjaftueshëm, veçanërisht në fushat që kanë të bëjnë me: ndarjen e qartë të detyrave, mangësitë gjatë procesit të vlerësimit të projekteve dhe procesimit të pagesave. Mangësi janë identifikuar edhe tek pranimi i faturave me ç`rast nuk është bërë protokolimi i tyre dhe raportimi në MF. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë zhvillimi i njohurive të stafit në sektorin e financave, menaxhimi i mirëfilltë i pasurive, plotësimi i pozitave me staf të rregullt dhe aplikimi i një procesi të rregullt të pranimit të faturave dhe raportimit të obligimeve të papaguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	4,154,339	3,670,564	3,526,175	29,631
Granti i Qeverisë -Buxheti	4,154,339	3,670,564	3,526,175	29,631

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 483,775€. Ky zvogëlim është rezultat i tërheqjes së mjeteve nga Ministria e Financave (MF) në fund të vitit, në kategoritë si: shërbime komunale, subvencione transfere dhe investime kapitale. Kjo, për shkak se MZHR nuk kishte arritur të shpenzoj këto mjete në projektet e planifikuara.

Në vitin 2018, MZHR ka shpenzuar 3,526,175€ ose 96% të buxhetit final.

Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	4,154,339	3,670,564	3,526,175	29,631
Pagat dhe Mëditjet	304,339	305,837	305,837	21,897
Mallrat dhe Shërbimet	340,000	340,000	236,727	7,734
Shërbimet komunale	10,000	4,174	1,678	
Subvencionet dhe Transferet	1,500,000	1,485,599	1,447,179	
Investimet Kapitale	2,000,000	1,534,954	1,534,754	

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 465,046€. Kjo, pasi MZHR nuk kishte arritur të realizoj në tërësi Programin e saj për Zhvillim Rajonal. Programi parashihte investimet përmes bashkëfinancimit me komunat, por këto të fundit nuk kishin arritur të realizojnë projektet e tyre si rezultat i vonës në procedura të prokurimit dhe fillimit të vonshëm të punimeve.
- Buxheti për mallra dhe shërbime nuk kishte pësuar ndryshime, ndërsa shpenzimi ishte 70%. Përkundër tepricave të buxhetit në këtë kategori, për shkak se mjetet nuk ishin zotuar me kohë dhe faturat ishin pranuar pas afatit të zotimeve, një shumë e detyrimeve prej 2,140€ kishte mbetur e papaguar.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Buxheti për shërbime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,825€. Përkundër kësaj, shpenzimet në këtë kategori ishin vetëm 1,678€ ose 40% e buxhetit final.
- Një planifikim shumë më i mirë ishte bërë për buxhetin e pagave dhe mëditjeve, dhe ishte realizuar në shkallë maksimale prej 100%, ndërsa për subvencione dhe transfere 97%.

Planifikimi i buxhetit, megjithatë ka nevojë për përmirësime thelbësore për shkak se, nëse krahasohet niveli i ekzekutimit me buxhetin fillestar, del se planifikimet fillestare të buxhetit janë përmbushë vetëm 85%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 305,837€, dhe ishte realizuar në tërësi. Një korrigjim i lehtë i buxhetit fillestar ishte bërë më vonë, dhe fondi i pagave me buxhet final ishte rritur për 1,498€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2018 ishte 344,175€. Prej tyre ishin shpenzuar 238,405€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, furnizim me mobile dhe pajisje të TI-së më pak se 1,000€, shpenzime të reprezentacionit, riparime dhe mirëmbajtje, shpenzime të qirasë për zyre.

Çështja A2³ - Ndarje jo e duhur e detyrave

E gjetura Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, neni 62 pika 7 thekson se një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit.

Në dy nga tetë raste të testuara, respektivisht në kontratën “Shërbime të përkthimit për nevoja të MZHR-së”, në vlerë 7,729€, dhe kontratën “Shërbime të mbikëqyrjes profesionale të projekteve të MZHR-së për komunat”, në vlerë 8,800€, i njëjti zyrtar i cili kishte kryer vlerësimin e ofertave si anëtar i komisionit të vlerësimit, pas nënshkrimit të kontratës ishte caktuar edhe menaxher i kontratës/projektit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të vogël të stafit në dispozicion brenda ministrisë, ku si pasojë të njëjtit zyrtar i ngarkohej më shumë se një detyrë.

Rreziku Emërimi i zyrtarit si menaxher i projektit, për kontratën për të cilën kishte bërë vlerësimin e ofertave, mund të ketë efekt në mbikëqyrjen objektive të realizimit të kontratës dhe nuk është në pajtim me parimet e ndarjes së detyrave.

Rekomandimi A2 Ministri të siguroj se në rastin e caktimit të menaxherëve të kontratës, të respektohet parimi i ndarjes së detyrave.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,485,599€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 1,447,179€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e bizneseve të reja dhe ato ekzistuese për veprimtari të ndryshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe mbështetje ndaj OJQ-ve në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar. Në këtë kategori ne kemi testuar 57 mostra për qëllime të testimit substancial dhe 19 mostra për testim të pajtueshmërisë.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,534,954€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 1,534,754€. Ato kanë të bëjnë me investimet e bëra ndaj komunave lidhur me ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimit, ujësjellësit, ndërtesave administrative si dhe rregullimin e lumenjve.

³ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja.

Çështja A3 - Vlerësimi i kërkesave jo në pajtim me udhëzuesin

E gjetura Sipas Udhëzuesit për aplikant për realizimin e Programit për Zhvillim Rajonal dhe thirrjes për aplikim, komunat me rastin e aplikimit duhet të ofrojnë një projekt ideor me paramasë dhe parallogari si dhe dokumentacionin pronëso- juridik. Nga shtatë raste të testuara, në tri prej tyre kemi hasur në mangësitë si në vijim:

Komuna e Prizrenit, si aplikuese për projektet “Ndërtimi i infrastrukturës në fshatrat e Lumbardhit dhe Podgorit”, si dhe “Rregullimi i terreneve sportive dhe objekteve kulturore në Rajonin e Lumbardhit”- dhe Komuna e Mitrovicës aplikuese për projektin “Ndërtimi i rrugës dhe kanalit Suhodoll-Mitrovicë”, ishin përzgjedhur si përfituese të projekteve pa ofruar projektin ideor dhe dokumentet pronësore-juridike. Vlera e këtyre marrëveshjeve të nënshkuara për financim nga MZHR ishte 430,000€.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e neglizhencës së komisionit të vlerësimit gjatë kontrollimit të dokumentacionit.

Rreziku Përzgjedhja e projekteve për financim pa paramasat dhe parallogaritë e projekteve, si dhe dokumentet pronësore, rrit rrezikun e definimit të sasive dhe cilësisë së punimeve, dhe rrjedhimisht edhe të kostove shtesë të projekteve. Në rast të tejkalimit të punimeve apo problemeve pronësore, projektet mund të mos realizohen për një kohë të gjatë.

Rekomandimi A3 Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura dhe se gjatë procesit të vlerësimit të projekteve për financim nga ministria, përmes formimit të një komisioni profesional, duhet të respektohen në mënyrë rigorozë kriteret e vendosura dhe dokumentacionit mbështetës që siguron realizimin e projektit.

Çështja A4 - Trajtimi jo i barabartë ndaj projekteve aplikuese gjatë vlerësimit

E gjetura Në Udhëzuesin për aplikant për realizimin e Programit për Zhvillim Rajonal, përcaktohet se kërkesat për financim nga komunat, duhet të jenë nga 50,000€ deri në 200,000€.

Në shtatë raste të testuara, kemi vërejtur se gjatë vlerësimit të projekteve aplikuese, komisioni kishte diskualifikuar projektet aplikuese nga komunat partnere “Kaçanik-Ferizaj” dhe “Klllokot-Viti” për shkak se kishin aplikuar për financim mbi vlerën e kufizuar prej 200,000€, ndërsa këtë kriter nuk e kishte zbatuar për projektet aplikuese nga komuna e Pejës si dhe ajo e Hanit të Elezit cilat i kishte shpallur si të përgjegjshme, ndonëse kërkesat e tyre për financim ishin poashtu mbi vlerën 200,000€.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes ndaj punës së kryer nga komisioni i vlerësimit, i cili nuk kishte treguar përgjegjshmërinë e duhur gjatë vlerësimit.

Rreziku Vlerësimi jo i drejtë i aplikacioneve ndaj të gjitha komunave, rrezikon favorizimin e komunave përkatëse dhe diskriminimin e komunave tjera, si pasojë e trajtimit jo të barabartë të tyre.

Rekomandimi A4 Ministri, duhet të siguroj mekanizma më efektiv të mbikëqyrjes ndaj procesit të vlerësimit dhe të siguroj se kriteret aplikohen njëjtë ndaj të gjithë aplikuesve.

Çështja A5 - Mangësi në realizimin e pagesave

Gjetja Bazuar në marrëveshjet e mirëkuptimit mes MZHR-së dhe komunave, tek kushtet e pagesës kërkohet që komuna t'i siguroj ministrisë, sigurinë e ekzekutimit nga operatori ekonomik sipas kushteve të kontratës.

Në dy nga 28 pagesa të testuara, kemi vërejtur se siguria e ekzekutimit që kishte bashkangjitur komuna në dokumentacionin për pagesë, nuk ishte sipas kushteve të kontratës sepse ishte me afat të skaduar. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së përvojës lidhur me kontrollimin e dokumentacionit nga ana e zyrtarëve financiar, meqë ishin ndër pagesat e para të realizuara për shpenzime kapitale.

Rreziku Realizimi i pagesave në mungesë të dokumentacionit të plotë, rrezikon sigurinë për punët e kryera sipas cilësisë dhe kushteve në kontratë.

Rekomandimi A5 Ministri të siguroj se procesit të realizimit të pagesave i paraprin një kontroll i detajuar duke siguruar se dokumentacioni është i plotë bazuar në kushtet e marrëveshjeve të mirëkuptimit.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve të ministrisë, pasuritë kapitale ishin shpалosur në vlerë 1,534,753€, ndërsa ato jokapitale në vlerë 50,903€. Çështjet lidhur me vlerën e shpалosur të pasurive në PFV, i kemi trajtuar tek kapitulli i Opinionit të Auditimit - Theksimi i Çështjes.

Çështja A6 – Mos inventarizimi i pasurisë

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 18, kërkon që organizatat buxhetore të inventarizojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të saj. Raporti i inventarizimit duhet të bëhet para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore.

Ndonëse Zyrtari Kryesor Administrativ kishte marrë vendim për formimin e komisionit për inventarizim të pasurisë jo financiare, komisioni ende nuk kishte arritur ta kryej këtë proces, edhe pse kishte përfunduar periudha e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore. Kjo vonesë në kryerjen e këtij procesi, kishte ndodhur si pasojë e mos familjarizimit të stafit lidhur me kryerjen e këtij procesi.

Rreziku Mos kryerja e procesit të inventarizimit me kohë, nuk ofron sigurinë për ekzistencën fizike të pasurive në ditën e regjistrimit, si dhe pamundëson paraqitjen e saktë të informatave lidhur me pasuritë në PFV dhe shpалosjen e tyre në mënyrë të drejtë. Kjo gjithashtu ka efekt në menaxhimin dhe kontrollin e duhur ndaj pasurive të ministrisë.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të rris masat e përgjegjësisë ndaj komisionit të inventarizimit të pasurisë, në mënyrë që raporti i përgjithshëm i inventarizimit të dorëzohet në kohën para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, ashtu që ndryshimet e mundshme të identifikuar të cilat përcaktohen pas inventarizimit, të pasqyrohen në regjistrat e pasurisë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 3,580€. Kjo vlerë ka rezultuar të jetë e nënvlerësuar dhe këtë e kemi trajtuar tek kapitulli 2.2- Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Çështja A7 – Mos protokolimi i faturave dhe mos raportimi i obligimeve të papaguara

Gjetja Bazuar në nenin 24 të Rregullës Financiare 01/2013, Shpenzimi i Parave Publike, kërkohet që fatura e cila pranohet duhet të protokolohehet dhe të evidentohet në librin e faturave. Njëkohësisht, sipas nenit 5 të Rregullës Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara, të gjitha organizatat buxhetore, janë të obliguara që të raportojnë obligimet e papaguara përmes raporteve mujore në Ministrinë e Financave.

Nga gjithsej 36 pagesa të testuara nga mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale në vlerë 1,550,914€, kemi vërejtur se faturat nuk janë protokoluara dhe as nuk është shënuar numër rendor i protokolit. Pranimi i faturave nga ministria bëhej duke shënuar datën e pranimit dhe nënshkrimin nga zyrtari i arkivës.

Në tri raste, faturat nuk ishin raportuar në MF si obligime të papaguara të muajit paraprak. Ministria kishte raportuar obligimet e saj të papaguara vetëm në muajin janar dhe jo në muajt pasues.

Këto mangësi kishin ndodhur për shkak se zyrtarët përgjegjës nuk kishin informacionin e duhur mbi procedurat për pranimin e faturave si dhe kërkesave për raportim të obligimeve, të përcaktuara me rregulla të Thesarit.

Rreziku Mos protokolimi i faturave me rastin e pranimit, rrit rrezikun që faturat të mos evidentohen me rregull dhe të shkaktohen vonesa në pagesën e tyre. Ndërsa mos raportimi i obligimeve të papaguara, ndikon në pasqyrimin jo të saktë të obligimeve të ministrisë.

Rekomandimi A7 Ministri të siguroj që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me informimin apo trajnimin e stafit sa i përket rregullave të Thesarit dhe të siguroj zbatimin e një procesi të rregullt të evidentimit të faturave dhe raportimit të rregullt të obligimeve të papaguara.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që duhet të plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MZHR, funksionimin e saj si ministri e ka filluar në fund të vitit 2017. Në mungesë të stafit operativ, kjo ministri kishte nënshkruar marrëveshje me MAPL-në, për mbështetje në kryerjen e shërbimeve financiare/administrative. Gjatë kësaj periudhe, ishte përballur me sfida lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare të saj, për shkak të mungesës së stafit. Megjithatë, në fund të vitit kishte arritur të rekrutoj një pjesë të stafit përfshirë shumicën e pozitive menaxheriale. Sidoqoftë, finalizimi i strukturës organizative dhe plotësimi i pozitive të punës ende mbetet një sfidë për ministrinë.

Ndonëse në numër të vogël, linjat e raportimit kanë funksionuar aty ku ka qenë e mundshme, me ç'rast Sekretari i Përgjithshëm është informuar lidhur për ecuritë operative dhe financiare brenda ministrisë përmes raporteve javore të cilat kanë përfshirë të dhëna të përgjithësuara lidhur me aktivitetet financiare dhe operacionale.

MZHR, ka arritur që pyetëtorin e vetëvlerësimit ta dërgoj me kohë në Ministrinë e Financave si dhe ka hartuar listën e rreziqeve brenda organizatës, megjithatë gjatë vitit 2018 nuk kishte pasur rishikim të rregullt të këtij registri, për të përcaktuar nëse janë marrë veprimet ashtu siç është planifikuar dhe nëse është bërë ndonjë ndryshim në vlerësimet e rrezikut. Gjithashtu, mungonte identifikimi i personave kyç për trajtimin e rreziqeve, si dhe vendosja e mekanizmave për kërkesa të raportimit nga këta persona për çështjet e identifikuara me rrezik.

Ministria nuk ka një plan strategjik, por ka të hartuar planin e punës për vitin 2018. Objektivat e saj janë të vendosura përmes Programit të Qeverisë 2017 – 2021.

Ministria ka arritur të shpenzoj buxhetin e saj në nivel të kënaqshëm, përveç në fushën e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale ku ka shpenzim më të ulët, ndërsa tek investimet kapitale, programin e saj për zhvillim rajonal ku përfshihen financimi i projekteve kapitale për komunat, nuk kishte arritur ta realizonte sipas planit, dhe si rezultat, një pjesë e mjeteve në fund të vitit iu kishte tërhequr nga MF. Njësia e auditimit të brendshëm ende nuk është e formuar dhe mungesa e saj përbën një mangësi në fushën e qeverisjes së mirë brenda ministrisë.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MZHR, nuk e ka formuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Megjithatë, MZHR kishte marrë veprime duke iu drejtuar NJQHAB /MF, me kërkesën për mbështetje në fushën e auditimit të brendshëm për vitin 2018 nga NJQH apo përmes lidhjes së ndonjë marrëveshje mirëkuptimi me ndonjë institucion tjetër. Sa i përket vitit 2018, nuk kishte marrë përgjigje nga Ministria e Financave, përkatësisht departamenti i auditimit të brendshëm, lidhur me ofrimin e shërbimit për kryerjen e auditimit të brendshëm në ministri.

Çështja A8 - Mos themelimi i NJAB-së

Gjetja Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, neni 3, përcakton që menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik, themelon NjAB-në me plotësimin e ndonjërit prej tri kriterëve: buxheti vjetor mbi 1 milion euro; mbi 50 të punësuar me orar të plotë; dhe në raste të veçanta për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë dhe me pëlqimin e institucioneve përgjegjëse.

MZHR, megjithëse plotësonte kriterin e parë, duke qenë se buxheti vjetor për vitin 2018 ishte mbi 4 milion euro, nuk kishte arritur të themeloj NjAB-në.

Kjo për shkak se dy zyrtarë brenda ministrisë, të cilët kishin ndjekur trajnimet në fushën e auditimit të brendshëm, nuk kishin arritur të certifikohen.

Rreziku Mungesa e auditorit të brendshëm, ndikon në mos identifikimin e dobësive të mundshme dhe mos ofrimin e sigurisë ndaj menaxhmentit lidhur me funksionimin dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa, në mënyrë që shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen përmes themelimit të NjAB-së brenda ministrisë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë mjaftueshëm efektive për të mundësuar një përgjigje me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja A9 - Dobësitë në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Gjetja Si pasojë e mos funksionalizimit të tërësishëm të strukturës organizative duke qenë ministri rishtazi e themeluar, një numër i pozitive, përfshirë edhe ato menaxheriale, nuk kishin arritur të plotësohen. Rrjedhimisht, në raste të caktuara, kishte pasur sfida në ndarjen e detyrave, pasi të njëjtit zyrtar iu kishte ngarkuar më shumë se një detyrë. Mungesa e kontrolleve të duhura kishte bërë që të ketë mangësi gjatë procesit të vlerësimit të projekteve kapitale dhe realizimit të pagesave në fundvit. Mos familjarizimi me legjislacionin në fuqi nga zyrtarët financiar kishte bërë që të ketë mangësi në menaxhimin e pasurive dhe obligimeve të papaguara, duke rezultuar me theksim të çështjes në raportin e auditimit.

Ministria ka regjistruar rreziqeve, por mungon identifikimi i rreziqeve në nivel të departamenteve dhe marrja e masave për menaxhimin e tyre dhe raportimin tek Zyrtari Kryesor Administrativ.

Rreziku Mekanizmi i dobët i llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë jo të mirë, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë, duke rritur rrezikun për shpenzime të parregullta.

Rekomandimi A9 Ministri të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë dhe ecuritë buxhetore, përfshirë edhe shpenzimet si subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, identifikimi i rreziqeve të bëhet në nivel të departamenteve dhe të merren masa për menaxhimin e tyre duke përfshirë raportimin/rishikimin e regjistrit në baza të rregullta (tre mujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprime ashtu siç është planifikuar.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

MZhR, nuk është audituar më parë, andaj nuk ka analizë për progresin e rekomandimeve paraprake.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
A1	PFV	Ministri duhet të ndërmerë të gjitha veprimet e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë kapitale tek komunat për projektet e përfunduara, por që ende gjenden në regjistrin e pasurive të ministrisë. Gjithashtu, të siguroj se edhe procesi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale është kryer sipas kërkesave ligjore dhe të gjitha obligimet e pa paguara janë prezantuar drejt në PFV.
A2	Mallrat dhe shërbimet	Ministri, të siguroj se në rastin e caktimit të menaxherëve të kontratës, të respektohet parimi i ndarjes së detyrave.
A3	Investimet Kapitale	Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura dhe se gjatë procesit të vlerësimit të projekteve për financim nga ministria, përmes formimit të një komisioni profesional, duhet të respektohen në mënyrë rigorozë kriteret e vendosura dhe dokumentacionit mbështetës që siguron realizimin e projektit.
A4	Investimet Kapitale	Ministri, duhet të siguroj mekanizma më efektiv të mbikqyrjes ndaj procesit të vlerësimit dhe të siguroj se kriteret aplikohen njëjtë ndaj të gjithë aplikuesve
A5	Investimet Kapitale	Ministri, të siguroj se procesit të realizimit të pagesave i paraprin një kontroll i detajuar duke siguruar se dokumentacioni është i plotë bazuar në kushtet e marrëveshjeve të mirëkuptimit.
A6	Pasuritë jonfinanciare	Ministri duhet të rris masat e përgjegjësisë ndaj komisionit të inventarizimit të pasurisë, në mënyrë që raporti i përgjithshëm i inventarizimit të dorëzohet në kohën para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, ashtu që ndryshimet e mundshme të identifikuar të cilat përcaktohen pas inventarizimit, të pasqyrohen në regjistrat e pasurisë.
A7	Obligimet e papaguara	Ministri të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme lidhur me informimin apo trajnimin e stafit sa i përket rregullave të thesarit dhe të siguroj zbatimin e një procesi të rregullt të evidentimit të faturave dhe raportimit të rregullt të obligimeve të papaguara.
A8	Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa, në mënyrë që shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen, përmes themelimit të NjAB-së brenda

	m	ministrisë.
A9	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Ministri të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë dhe ecuritë buxhetore, përfshirë edhe shpenzimet si subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga menaxhmenti. Gjithashtu, identifikimi i rreziqeve të bëhet në nivel të departamenteve dhe të merren masa për menaxhimin e tyre duke përfshirë raportimin/rishikimin e regjistrit në baza të rregullta (tre mujore) për të përcaktuar nëse janë marrë veprime ashtu siç është planifikuar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI PRILË DËSTAVJEN: 11.04.2019 DATE REC'D / VERSUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif.klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	419	1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE DALËSE / IZLAZNA / OUTGOING	
Nr./Br./No	237
Nr.faq / Br.str / No.pg	10 / 04 / 2019
Data / Datum / Date	
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINE	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Zhvillimit Rajonal
 Ministarstvo za Regionalni Razvoj
 Ministry of Regional Development

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Rasim Demiri

Ministër - Ministria e Zhvillimit Rajonal,

Data: 10 Prill 2019, Prishtinë,